



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/03/23
Datë: 21.03.2023 .

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: **Shpejtim Gacaferi** – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: Mbledhja e tretë - (2023) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 31.03.2023, ora 10⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Kërkesë për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2022 sipas programeve;
3. Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023;
4. Informatë nga Drejtoria për Sherbime Publike dhe Inspektim rreth mirëmbajtjes së rrugëve në sezonin dimeror, ndriçimit publik dhe shërbimit të mbeturinave të Amvisërisë në Komunën e Junikut;
4. Shqyrimi dhe miratimi i kërkesës nga DUKM-ja që parcelat kadastrale me numër: P- 73105038-00491-2, P-73105038-00491-3 dhe P-73105038-00491-4 Zona kadastrale e Junikut të shpallen zona me interes të përgjithshëm publik;
5. Shqyrimi dhe miratimi i kërkesës nga DUKM-ja që parcelat kadastrale me numër: P- 73105038-00069-0 Zona kadastrale e Junikut të shpallet zonë me interes të përgjithshëm publik;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i draft- Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut;
7. Të ndryshme.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 02-02/23
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATE/A	28.02.2023
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL:

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së dytë (2) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 28.02.2023, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, Kryetarin e komunës së Junikut z. Ruzhdi Shehu, nënkryetarin e Komunës së Junikut z. Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit me pas konstatoi se mbledhje marim pjesë të 14 antaret e kuvendit. Në mbledhje nga drejtoret prezent ishin: znj. Leunora Shehu-AD, znj. Vjollca Qestaj-DBF, znj. Gentiana Tofaj-DZHE, z. Xhavit Velijaj DAKRS, z. Fatos Shala-DSHMS dhe z. Demokrat Ganijaj-DSHPMSI

Anëtarët prezent

- | | |
|---------------------------------------|---|
| 1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK | |
| 2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK | |
| 3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK | |
| 4. Mursel Salihaj-Anëtar, LDK | |
| 5. Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK | |
| 6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK | |
| 7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK | |
| 8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK | |
| 9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK | |
| | 10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK |
| | 11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK |
| | 12. Festina Maloku - Anëtare, AAK |
| | 13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV (Mungon) |
| | 14. Eliza Pepshi-Anëtare, LVV |
| | 15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV |

Rendi i ditës i paraparë

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Informatë e Kryetarit të Komunës mbi Planin e Ekzekutivit për vitin 2023,
3. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2022,
4. Shqyrtimi i draft-planit të Veprimit për Transparencë 2023-2026,
5. Informatë rreth suksesit të nxënësve të Shkollës Filllore të Mesme të Ulet “Edmond Hoxha” dhe Shkollës së Mesme “Kuvendi i Junikut”, dhe rreth përgatitjeve për fillimin e gjysëmvetorit të dytë,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë për Shërbime Publike, Inspektim, Mbrojtje dhe Shpëtim /MSHPIMSH/ për formimin e komisionit për hartimin e Draft-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut,
7. Shqyrtimi i Raportit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2022,
8. Shqyrtimi i Planit të Punës dhe orarit të mbajtjes të Mbledhjeve të Komitetit për Komunitete për vitin 2023, dhe
9. Të ndryshme.

z.Shpejtim Gacaferi, para se ta votojmë rendin e ditës, kam një kërkesë nga kryetari i Komunës që pikat 2,3 dhe 4 të zhvendosen për shqyrtim me vonë pasi që kryetari ka një takim. Fillojmë pikën:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Informatë rreth suksesit të nxënësve të Shkollës Filllore të Mesme të Ulet “Edmond Hoxha” dhe Shkollës së Mesme “Kuvendi i Junikut”, dhe rreth përgatitjeve për fillimin e gjysëmvetorit të dytë,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë për Shërbime Publike, Inspektim, Mbrojtje dhe Shpëtim, /MSHPIMSH/ për formimin e komisionit për hartimin e Draft-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut,
4. Shqyrtimi i Raportit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2022,
5. Shqyrtimi i Planit të Punës dhe orarit të mbajtjes të Mbledhjeve të Komitetit për Komunitete për vitin 2023,
6. Informatë e Kryetarit të Komunës mbi Planin e Ekzekutivit për vitin 2023,
7. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2022,
8. Shqyrtimi i draft-planit të Veprimit për Transparencë 2023-2026,
9. Të ndryshme.

z.Shpejtim Gacaferi, e qes ne votim rendi e ditës kush është për? për 14 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se rendi i ditës u miratua, kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesa nuk ka, e qes ne votim procesverbalin e mbledhjes se kaluar, kush është për? për 14 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se procesverbali i mbledhjes janar 2023 u miratua.

2. Informatë rreth suksesit të nxënësve të Shkollës Filllore të Mesme të Ulet “Edmond Hoxha” dhe Shkollës së Mesme “Kuvendi i Junikut”, dhe rreth përgatitjeve për fillimin e gjysëmvjetorit të dytë,

Informatën e beri z.Xhavit Velijaj, Drejtor i DAKRS, i cili fillimisht i përshëndeti te gjithë e me pas i informojë anëtarët e kuvendit rreth suksesit ne te dy shkollat e komunës se Junikut.

z.Zenel Maloku, përshëndetje për te gjithë, me aq sa e përcjella drejtorin, për rënie te suksesit te shkolla e mesme, ne 2.62 dhe mendimi im është nëse mesatarja e suksesit nuk arrihet bile notën 3 atëherë nuk është ka punohet aq sa duhet, nëse themi se kushtet janë te dobëta mendoj se kjo nuk qëndron sepse vitin e kaluar nuk ka pasur nxemje ndërsa këtë vite ka nxemje, koha e pandemisë ka kaluar, edhe pse me sukses më mirë ishin ne kohen e pandemisë se sa tani, andaj unë ju pyes drejtor se ku qëndron çështja, ku ja ka dhanë “kosa gurit”?

z.Xhavit Velijaj, sa i përket suksesit me aq sa kam mundur ti përcjelli me herët notën mesatare me e ulët është në gjimnaz, e këtë çështje e kam pas ngritur edhe unë sa isha këshilltar i këtij kuvendit, dhe kam vërejtur se problemi është se ne gjysëmvjetorit e parë kemi këtë notë mesatare ndërsa ne gjysmë vjetorin e dytë kjo notë po ngritët.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka, kalojmë ne pikën e radhës.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë për Shërbime Publike, Inspektim, Mbrojtje dhe Shpëtim /MSHPIMSH/ për formimin e komisionit për hartimin e Draft-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Junikut,

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesa ka te beje me formimin e komisionit, qe përbëhet prej 11 anëtarëve, 8 janë nga ekzekutivi dhe 3 janë nga kuvendit kështu qe po fillojmë me propozime.

LDK propozon z.Mursel Salihaj

AAK propozon znj.Erleta Qestaj

LVV propozon z.Xhemë Tofaj

z.Shpejtim Gacaferi, faleminderit për propozimet, po i lexoj te gjithë anëtarët e propozuar, z.Demokrat Ganijaj-Kryesues, z.Rrustem Pepshi –anëtar, z.Arian Xhuli-anëtar, z.Turim Ganijaj-anëtar, z.Ali Gacaferi-anëtar, znj.Vjollca Qestaj-anëtare, z.Idriz Gacaferi-anëtar, znj.Valbona Gaxherri-Gacaferi-anëtare, z.Mursel Salihaj-antar LDK, znj.Erleta Qestaj-anëtare AAK dhe z.Xhemë Tofaj-anëtar LVV, e qes ne votim.

z.Leonard Llojuni, përshëndetje për te gjithë, kryesues ne këtë rast ti nuk ke drejtë të votosh, sepse paraqet konflikt interesi pasi qe ke ne këtë propozim bashkëshorten znj. Valbona Gaxherri-Gacaferi.

z.Shpejtim Gacfari, po unë tërhiqem nga votimi, kush është për? për 13 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se ky komision u miratua.

4. Shqyrtimi i Raportit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2022,

z.Zenel Maloku, unë si anëtar i këtij komiteti beje kërkesë qe kërkesat qe dalin nga ky komitet te merën për bazë dhe me seriozitet nga ana e ekzekutivit.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka, kalojmë ne pikën tjetër me radhë.

5. Shqyrtimi i Planit të Punës dhe orarit të mbajtjes të Mbledhjeve të Komitetit për Komunitete për vitin 2023,

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë nuk ka, kalojmë ne pikën tjetër me radhë.

6. Informatë e Kryetarit të Komunës mbi Planin e Ekzekutivit për vitin 2023,

Informatën e sqaroi dhe e arsyetoi z.Ruzhdi Shehu kryetar i Komunës se Junikut, i cili fillimisht i përshëndeti te gjithë me pas e sqaroi dhe e arsyetoi para anëtarëve te kuvendit plani e ekzekutivit për vitin 2023.

z.Zenel Maloku, desha te dijë për rrugën “Gjocaj” a keni ndarë mjete për këtë vit, dhe kam një kërkesë qe te ndërtohet një kanalizim i ujitjes sepse fusha e fshatit Jasiq nuk ka ujitje pa atë kanal.

z.Ruzhdi Shehu, ne nuk e kemi ne plane qe këtij viti këtë kanal te ujitjes, por do te shikojmë mundësitë tjera qe ta ndërtojmë këtë kanal te ujitjes, te shikojmë gjatësinë dhe te bëjmë një projekt, dhe do te shikojmë brenda mundësive te ndërtojmë edhe këtë kanal te ujitjes.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka, kalojmë ne piken tjetër me radhë.

7. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2022,

Raportin e punës se kryetarit para anëtarëve te Kuvendit e prezantoi z.Ruzhdi Shehu Kryetar i Komunës se Junikut.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka, kalojmë ne piken tjetër me radhë.

8. Shqyrtimi i draft-planit të Veprimit për Transparencë 2023-2026,

z.Ruzhdi Shehu, draft Planin e veprimit e keni dhe ne cilësinë e koordinatorit për transparencë fjalën ja kaloj z.Rrustem Pepshi qe ta sqaroj dhe ta arsyetoje me tutje këtë draft-plan te veprimit.

Sqarimin dhe arsyetimin e draft-planit të veprimit të transparencës 2023-2026 e beri koordinatori për transparencë z.Rrustem Pepshi i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë, me pas e sqaroj dhe e arsyetoj para anëtarëve të kuvendit, draft planin e veprimit 2023-2026.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë nuk ka, kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës.

9. Të ndryshme.

z.Leonard Llojuni, me qene se është edhe kryetari i komunës prezent unë kam një lutje që ka të beje me shtëpinë e bjeshkatarëve, në lokacionin livadhi i madh, ai objekt çdo ditë është ka dëmtohet dhe kemi një vite që nuk është ndërmarr asgjë lidhur me të, dhe mua me intereson se cili është plani i kryetarit që ta mirëmbajë atë projekt, çfarë statuti do ti ipet pasi që si komunë turizmin e kemi prioritet, mua me shqetëson fakti që ai objekt ka mbetur ashtu dhe se mendoj se e pakta që është mundur të bëhet nga kryetari është që ai objekt ti ipet ndonjëherë prej shoqatave të bjeshkatarëve.

z.Ruzhdi Shehu, po është e vërtetë kjo, ne jemi duke punuar në atë drejtim, jemi në bisedime me agjencionin e pyjeve që të mos kemi pengesa lidhur me pronën, është shqetësim me vend, kemi dy here e kemi shikuar dhe kërkohet që të ndërhyhet për rrethë objektin, por duhet të nisen biseda me agjencionin e pyjeve që të na ipet të shfrytëzohet.

z.Zenel Maloku, kam një pyetje për kryetarin, u tha se Kryetari ka qenë në Pejë të parku nacional, dhe në atë takim kam parë kryetar të komunave që kanë marrë edhe qytetar me veti, kryetari ynë me sa di ka qene vetëm në atë takim kjo nuk ka rëndësi, por çka është me rëndësi është që të dimë a ka mundur të bëjnë marrëveshje me parkun nacional për pronat private që janë në këtë park apo vetëm e keni humbur atë ditë kot, unë kam bërë kërkesë që pronat tona të hiqen nga parku nacional, e di se është e vështirë por dua të informohem në pika të shkurta se a keni mundur të bëni diçka.

z.Ruzhdi Shehu, mbledhja ka qenë e hapur për publik, dhe kush ka dashur ka mundur të marrë pjesë, unë kam marrë pjesë në atë mbledhje ku kanë qene edhe kryetarët tjerë të komunave që kanë pjesë në parkun nacional, dhe të them të drejtën të gjithë e kanë të njëjtin problem dhe në këtë drejtim kemi patur të njëjtin qëndrim, ne kemi thënë që të hiqet vija e parkut nacional në nivel me të lartë sepse jemi të dëmtuar, mirë por ligji mbi parkun është i veçantë dhe është në fazën e hartimit, ne i kemi dhënë komentet tona dhe kemi lanë prap takim me hartuesit e këtij ligji të gjithë në komuna e regjionit të Dukagjinit.

z.Zenel Maloku, me rregull sot unë nuk mundem të ndërtoj në pronën time një shtëpi pa lejen e Parkut, nuk mundem të beje krasitjen e seqeve dhe largimin e tyre pa lejen e parkut, atëherë shtrohet pyetja kush dha lejen "bagerit" që të bëjë zgjerimin e rrugës të pronës ime edhe atë pa me pyetur as mua, atëherë përderisa ka të drejtë parku për mos me lenë të ndërtohet, edhe unë kam të drejtë që në pjesën time që e kame me flete poseduese të mos lejoj të ndërtohet rruga.

z.Ruzhdi Shehu, ndërtimi i rrugës ka një leje që ka marrë në vitin 2011, ka pëlqim nga të gjithë kemi procesverbalet, dhe ne e kemi ngritur këtë çështje që fshatrave "Gjocaj dhe Jasiq" të ju lejohet ndërtimi në pronat e tyre.


z. Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka, e shpalli te mbyllur mbledhjen e shkurtit.

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha

Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	13.03.2023
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi-- Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës, Junik
NGA/OD/FROM:	znj. Vjollca Qestaj- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2022 sipas programeve.

I nderuar,

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 13, neni 58 dhe Statutit të Komunës së Junikut me Nr. 001/3127 të datës 29.09.2010 neni 43 dhe Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, në mënyrë që të mund ti alokojmë tejkalimin e hyrave kërkojmë që të bëhet ndryshimi i planit të buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2022 sipas programeve.

E hyra vetanake për vitin 2022 sipas planifikimit dhe realizimit

Tabela e planit dhe realizimit:

Nr.	Te hyrat	Planifikimi	Realizimi vjetor 2022	Diferenca (+, -)
1	Te hyrat nga shërbimet kadastrave	11,481.00	14,472.86	2,991.86
2	Te hyrat nga urbanizmi	19,100.00	12.00	-19,088.00
3	Te hyrat nga administrata	7,100.00	6,654.50	-445.50
4	Te hyrat nga lejet për ush.vepr. bizneseve	10,000.00	12,330.57	2,330.57
5	Te hyrat nga tatimi ne pronë dhe në tokë	92,557.00	96,238.45	3,681.45
6	Regjistrimi i Automjeteve	6,000.00	7,668.00	1,668.00
7	Te hyrat nga shëndetësia	6,200.00	6,210.50	10.50
8	Te hyrat nga shërbimet e inspektimit	4,100.00	2,180.00	-1,920.00
9	Të hyrat tjera	144,219.19	202,602.25	58,383.06
	TOTALI	300,757.19	348,369.13	47,611.94

Shuma totale e të hyrave vetanake të inkasuara në periudhën Janar – Dhjetor 2022 duke përfshirë të gjitha të hyrat është gjithsejtë: **348,369.13€**. Shuma e planifikuar për vitin 2022 është **159,038.00€**, gjatë vitit 2022 është bërë ndryshimi i këtij plani në shumë prej **141,719.19**, Totali i planifikimit pas këtij ndryshimi është **300,757.19€** ku shifet se kemi tejkalim të inkasimit të të hyrave vetanake për vitin 2022 në vlerë prej **47,611.94€** në këtë shumë janë të përfshira edhe të hyrat nga Gjocat në trafik në shumë prej **8,077.50€**.

Në mënyrë që të mundemi të alokojmë tejkalimin e të hyrave, kërkojmë që të rritet planifikimi i të hyrave vetanake në shumë prej **47,611.94€**, totali i të hyrave për vitin 2022 të rritet nga **300,757.19€** në **348,369.13€**.

Kjo rritje në vlerë prej **47,611.94€**, të bartet si në vijim :

- Nën programi 48020 Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në projektin Bashkëfinancimi i projekteve me kod të projektit **46030 – 47,611.94€**.

Ju faleminderojmë për mirëkuptim!



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
01/Nr. Procl. 2-155/2170
Njës. Cog 7
Nr. i faq 1303
Data 13.03.2023



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

DATE/A:	13.03.2023
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi– Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës, Junik
NGA/OD/FROM:	znj. Vjollca Qestaj- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023.

I nderuar,

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 13, neni 58 dhe Statutit të Komunës së Junikut me Nr. 001/3127 të datës 29.09.2010 neni 43 dhe Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, kërkojmë që të bëhet bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti 2022 në vitin 2023.

Në vitin 2022 janë planifikuar të inkasohen të hyra vetanake në vlerë prej 159,038.00€, ndërsa shuma e inkasuar për vitin 2022 duke përfshirë edhe të hyrat nga gjobat në trafik dhe tejkalimin e të hyrave është 348,369.13€. Të hyrat e bartura nga viti 2021 në vitin 2022 janë në vlerë prej 91,915.99€ ku gjithsej të hyra në vitin 2022 duke i përfshirë e dhe të hyrat e bartura janë 440,285.12 €. Nga kjo shumë e të hyrave vetanake gjatë vitit 2022 janë shpenzuar gjithsej 245,134.52€.

Shuma e mbetur për bartje është 195,150.60 € ku kërkojmë që bartja të bëhet në këto Programe dhe kategori ekonomike si vijon:

Kategoria e investimeve kapitale 155,476.79€

- Shuma prej 14,050.00 € të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 51315 "Asfaltimi i rrugës lokale Junik - Jasiq", në Programin Shërbime publike me kod 180, në nën programin Infrastruktura rrugore me kod 18020.
- Shuma prej 5,000.00€ të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 53232 "Furnizimi me gjenerator për objektin e Komunës", në Programin Administrata dhe Personeli me kod 163, në nën Programin Administrata me kod 16320
- Shuma prej 56,426.79 € të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin me kodin 46030 "Bashkëfinancimi i projekteve", në Programin Zhvillimi ekonomik me kod 480, në nën Programin Planifikimi i Zhvillimit ekonomik me kod 48020.
- ✓ • Shuma prej 55,000.00 € të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin (Projekt i ri) "Kanalizimi i ujërave të zeza lokacioni, Moronicë dhe lagjja Krasniq", në Programin Planifikim Urban dhe Mjedis me kod 660, në nën Programin Planifikimi Urban dhe inspeksioni me kod 66405.
- Shuma prej 20,000.00 € të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin (Projekt i ri) "Ndërtimi i mureve mbrojtëse lokacioni Tofaj dhe Pepsh", në Programin Planifikim Urban dhe Mjedis me kod 660, në nën Programin Planifikimi Urban dhe inspeksioni me kod 66405.
- Shuma prej 5,000.00 € të bartet në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale, në projektin (Projekt i ri) "Furnizimi me pajisje për analiza laboratorike në QKMF", në Programin Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale me kod 730, në nën Programin Shërbimet e shëndetësisë primare me kod 74200.


Kategoria e mallrave dhe shërbimeve 39,609.63€

- Shuma prej 30.609.63 € të bartet në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, në Programin Planifikim Urban dhe Mjedis me kod 660, në nën Programin Planifikimi Urban dhe inspeksioni me kod 66405.
- Shuma prej 5,000.00 € të bartet në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, në Programin Shërbime publike me kod 180, në nën programin Infrastruktura rrugore me kod 18020.
- Shuma prej 4,000.00 € të bartet në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, në Programin Arsimi dhe Shkenca me kod 920, në nën programin Administrata me kod 92100.

Kategoria e Subvencioneve **64.18€**

- Shuma prej **64.18 €** të bartet në kategorinë ekonomike subvencione, në Programin Zyra e Kryetarit me kod 160, në nën Programin Zyra e Kryetarit me kod 16020.

Në total të hyra për bartje nga viti 2022 në vitin 2023 janë **195,150.60 €**



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

REFERENC-Ë:	Nr.
DATE:	14.03.2023
PËR/ZA/TO:	z.Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës së Junikut
NGA/OD/FROM:	z.Zenun Shala – Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për propozim Vendim

Bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040), neni 42, pika j) të Statutit të Komunës së Junikut, (Nr. 001/3127, të datës: 29.9.2010), neni 38 paragrafi 1) i Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës Junikut, ju bëjmë këtë:

KËRKESË

Që të vendosni në rendin e ditës në mbledhjen e radhës se Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit Komunal kërkesën për:

Shpalljen e parcelat kadastrale me numër: P-73105038-00491-2, P-73105038-00491-3 dhe P-73105038-00491-4 Zona kadastrale Junik interes i përgjithshëm publik.

P.S Propozim – Vendimi për shpalljen e parcelave kadastrale të lartëcekura interes përgjithshëm publik i Komunës së Junikut

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Në bazë të nenit 12.2 paragrafi d), nenit 17 paragrafi a) dhe c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040); nenit 10 paragrafi a) dhe b) si dhe nenit 22 paragrafi 4) i Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.09.201, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis propozon këtë:

Propozim: VENDIM

Për

SHPALLJEN E PARCELËS KADASTRALE NUMËR: P-73105038-00069-0, INTERES PUBLIK I KOMUNËS SË JUNIKUT

- I. Me këtë propozim Vendim shpallet interes publik i Komunës së Junikut parcelat numër: P-73105038-00491-2, P-73105038-00491-3 dhe P-73105038-00491-4 Zona kadastrale Junik.
- II. Objekt i shpalljes interes i përgjithshëm publik janë pronat e paluajtshme të cekura në pikën I. të këtij propozim vendimi në sipërfaqe të përgjithshme prej 15924 m², ku e njëjta evidentohet në emër të Pasuri Shoqërore, Industria e Bashkuar e tekstit E.Duraku- Gjakovë
- III. Komuna e Junikut do të kompensojë në shumën prej 20% të vlerës së pronës së likuiduar. Shuma prej 20% do t'ju kompensohet punëtorëve të ish-Ndërmarrjes Shoqërore sipas legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Në Komunën e Junikut pronat e paluajtshme në pronësi publike janë në sipërfaqe shumë të vogla, krahasuar me nevojat për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik-social. Andaj kjo komunë e ka të rëndësishme jetike kthimin e këtyre pronave në pronësi të saj kontretisht parcelat e cekura në pikën I. të këtij Propozim Vendimi.

Bazuar në Planin Zhvillimor Urban parcelat numër: P-73105038-00491-2, P-73105038-00491-3 dhe P-73105038-00491-4 me sipërfaqe të përgjithshme prej 15924 m², Zona kadastrale Junik, të cilat gjenden në vendit e quajtur "Baks-Fabrika", janë të destinuara për Industri të Lehtë dhe Ushqimore.

Komuna e Junikut planifikon parcelat e lartëcekura të shfrytëzohen për të njëjtat veprimtari d.m.th. **Industri të Lehtë dhe Ushqimore.**

Komuna e Junikut bazuar nga kërkesat e legjislacionit në fuqi mbi privatizimin dhe likuidimin e pasurisë së ish-ndërmarrjeve shoqërore merr për obligim që të kompensojë 20% të vlerës së pronës së likuiduar.

Këtij akti i bashkangjesim:

1. Certifikata e Pronësisë,
2. Kopja e Planit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životte Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : P.SH. INDUS.E BASHKU.E TEKSTILIT E.DURAKUGJA

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 6-942/3-2200
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 14.03.2023 - 10:50
Komuna / Opština / Municipality: JUNIK / JUNIK / JUNIK
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastal Office: JUNIK / JUNIK / JUNIK

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i afarizimit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri i Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Licni broj/broj ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Drzava državljanstva ili uknjiženja Country ofcitizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishmen †	Krijar me datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P.SH. INDUS.E BASHKU.E TEKSTILIT E.DURAKUGJA			/	KCID0503250	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO			

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhuruar Ažurirano Updated
JUNIK / JUNIK / JUNIK			JUNIK	

B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

Njësia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale katastarska zona Cadastral zone	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind	Kati/ Katet Br.Sprat a/ Spratova Floor number	Vendi i quajtur Zvano mesto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shfrytëzimi aktual/Kultura- klasa Aktualna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhurnuar Ažurirano Updated
P-73105038-00491-2	JUNIK / JUNIK / JUNIK	Junik / Junik / Junik	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë private Privatna Imovina Privately owned Land /		BAKS-FABRIKA / BAKS-FABRIKA / BAKS-FABRIKA	14467	Tokë Ndërtimore - Shitëpi-Ndërtese - / Tokë Ndërtimore - Oborr - / / Gradjevinsko zemljište - Kuca- Zgrada - / Gradjevinsko zemljište - Dvorište - / / Construction land - House-Building - / Construction land - Back Yard - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	
P-73105038-00491-3	JUNIK / JUNIK / JUNIK	Junik / Junik / Junik	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë private Privatna Imovina Privately owned Land /		BAKS-FABRIKA / BAKS-FABRIKA / BAKS-FABRIKA	851	Rajon Ujor - Proni/Përma - / / Vodeni Region - Potok - / / Water - stream - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	
P-73105038-00491-4	JUNIK / JUNIK / JUNIK	Junik / Junik / Junik	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë private Privatna Imovina Privately owned Land /		BAKS-FABRIKA / BAKS-FABRIKA / BAKS-FABRIKA	606	Rajon Ujor - Proni/Përma - / / Vodeni Region - Potok - / / Water - stream - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	





Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

Flurije Shehu





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastrel Office : JUNIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastrel Zone: Junik

Njësia/Jedlnica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m ²
P-73105038-00491-2	Parcelë / Parcela / Parcel	14467
P-73105038-00491-4	Parcelë / Parcela / Parcel	606
P-73105038-00491-3	Parcelë / Parcela / Parcel	851



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2500

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 14:03.2023

Koha/ Vreme/ Time: 10:47:50

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
01/Nr. Prot. 2-755/2207
Një. Org 2
Nr. i taq. 7
Data 14/03/2023



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

REFERENC-Ë:	Nr.
DATE:	14.03.2023
PËR/ZA/TO:	z.Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës së Junikut
NGA/OD/FROM:	z.Zenun Shala – Drejtor për Urbanizëm, Kadastrë dhe Mjedis
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për propozim Vendim

Bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040), neni 42, pika j) të Statutit të Komunës së Junikut, (Nr. 001/3127, të datës: 29.9.2010), neni 38 paragrafi 1) i Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës Junikut, ju bëjmë këtë:

KËRKESË

Që të vendosni në rendin e ditës në mbledhjen e radhës së Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit Komunal kërkesën për:

Shpalljen e ngastrës kadastrale me numër: P-73105038-00069-0, Zona kadastrale Junik interes i përgjithshëm publik.

P.S Propozim – Vendimi për shpalljen e parcelave kadastrale të lartëcekura interes përgjithshëm publik i Komunës së Junikut

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Në bazë të nenit 12.2 paragrafi d), nenit 17 paragrafi a) dhe c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040); nenit 10 paragrafi a) dhe b) si dhe nenit 22 paragrafi 4) i Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.09.201, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis propozon këtë:

Propozim: VENDIM

Për

SHPLLJEN E PARCELËS KADASTRALE NUMËR: P-73105038-00069-0, INTERES PUBLIK I KOMUNËS SË JUNIKUT

- I. Me këtë propozim Vendim shpallet interes publik i Komunës së Junikut parcela numër: P-73105038-00069-0, Zona kadastrale Junik.
- II. Objekt i shpalljes interes i përgjithshëm publik është prona e paluajtshme e cekur në pikën I. të këtij propozim vendimi në sipërfaqe të përgjithshme prej 20839 m², ku e njëjta evidentohet në emër të Pasuri Shoqërore, OPPB. KOSOVODRVO, Prishtinë-OP. GJERAVICA.
- III. Komuna e Junikut do të kompensojë në shumën prej 20% të vlerës së pronës së likuiduar. Shuma prej 20 % do t'ju kompensohet punëtorëve të ish-Ndërmarrjes Shoqërore sipas legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Komuna e Junikut ka mungesë të pronave publike, andaj në shumë raste kjo paraqet pengesë në realizimin e projekteve të karakterit zhvillimor.

Në parcelën numër P-73105038-00069-0 (me sipërfaqe të përgjithshme prej 20839 m²), Zona kadastrale Junik, Komuna e Junikut planifikon që të njëjtën t'a destinuar për zhvillimi ekonomik, respektivisht **Qendër për Rekreacion dhe Turizëm**.

Parcela në fjalë në elaboratin kadastral evidentohet në emër të ish Ndërmarrjes shoqërore "Kosovodrvo", e njëjta tani menaxhohet nga Agjencia Kosovare për Privatizim.

Komuna e Junikut bazuar nga kërkesat e legjislacionit në fuqi mbi privatizimin dhe likuidimin e pasurisë së ish-ndërmarrjeve shoqërore merr për obligim që të kompensojë 20% të vlerës së pronës së likuiduar.

Presim që në afat sa më të shkurtër do ta shqyrtoni dhe aprovoni propozimin tonë

Këtij akti i bashkangjesim:

1. Certifikata e Pronësisë,
2. Kopja e Planit.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office : JUNIK

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Junik

Njësia/Jednica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m ²
P-73105038-00009-0	Parcelë / Parcela / Parcel	20839



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2000

Punol/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 14.03.2023

Koha/ Vreme/ Time: 10:45:06

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënimi/Belshëka/Note:

Aprovot/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



[Signature]



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životte Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-73105038-00069-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	6-942/3-2200
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	14.03.2023 - 10:48
Komuna / Opština / Municipality:	JUNIK / JUNIK / JUNIK
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Junik / Junik / Junik
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	JUNIK / JUNIK / JUNIK

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA							
Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përkthim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-73105038-00069-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		20839			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
MALI MADH-LIVADHI MADH				




A2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Pyjorë/šumsko/Forestry	Tokat Pyjorë/šumsko zemljište/Forest	Mal I Klasës 2/Suma 2 Klase/2nd Class Forest	20719
2	Tokë Ndërtimore/Građevinsko zemljište/Construction land	Shtëpi- Ndërtese/Kuca-Zgrada/House-Building		120

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr.- personal Licen broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	P.SH.OPPB KOSOVODRVO PRISHTINE OP GJERAVICA	KCID0503194	DEQAN / DEQAN / DEQAN /		EDVARD KARDELI	1/1		



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

DATË/A:	20.03.2023
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi – Kryesues i Kuvendit Komunal
CC:	z. Ruzhdi Shehu – Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	z. Demokrat Ganiçaj – Drejtor për Shërbime Publike Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Informata mbi gjendjen e Shërbimeve Publike në Komunën e Junikut



I nderuar,

Bazuar në kërkesën tuaj Nr. Prot.9-155/2128 të datës 10.03.2023, lidhur me gjendjen e Shërbimeve Publike në Komunën e Junikut, më poshtë ju paraqesim informatat e kërkuara.

Sa i përket mirëmbajtjes dimërore ne nga viti i kaluar kemi nënshkruar kontratë dy vjeçare për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale në Komunën e Junikut, në këtë kontratë përfshihet largimi i borës nga rrugët, trotualet dhe shpërndarja e kripës.

Fatmirësisht këtë vit nuk ka pasur të reshura të borës dhe nuk është paraqitur nevoja që të intervenojmë në largim të borës duke përfshirë zonën urbane apo atë malore. Në rrugën që të shpien për bjeshkë ne kemi shprehur vullnetin që të intervenojmë por pas konsultes me shoqaten e bjeshkatarëve nuk na është rekomanduar që të intervenojmë për arsye se lëvizja e tyre është bërë me latrak.

Ne kemi intervenuar vetëm një herë në shpërndarje të kripës gjatë ditëve të cilat ishte temperatura shumë e ulët, intervenimi është bërë nga fshati Jasiq deri në fshatin Gjocaj për shkak që në rrugë kishte akull dhe rrezikonte qarkullimin e automjeteve.

Gjendja me ndriçim publik në Komunën e Junikut është jashtëzakonisht e mirë, ku mbi 95% të rrugëve janë me ndriçim publik, ndërsa është shtuar ndriçimi i ri në Lagjet: Qender, Kallavaj si dhe Makaj, po ashtu është duke vazhduar mirëmbajtja e rregullt e rrjetit të ndriçimit publik. Gjithashtu jemi duke përgaditur projektin për funksionalizim dhe ndertimi i rrjetit të ri të ndriçimit për gjatë shtratit të lumit Erenik

Sa i përket mirëmbajtjes verore, për këtë vit është në procedura të prokurimit kontrata për mirëmbajtje verore dhe rehabilitim të rrugëve lokale në Komunën e Junikut, gjithashtu është në procedura të prokurimit edhe sinjalizimi vertikal dhe horizontal, ku kemi planifikuar vendosjen e